

STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ PERFECT TRADE “ SH.P.K

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot, më 08.02.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ **PERFECT TRADE “ SH.P.K**
- (2) Themeluesi i shoqërisë eshte :
 - **ERGYS PASHAJ e datelindjes 20.01.1988** Lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, identikuar nepermjet Leternjoftim me ID Nr.Personal **I80120103L**, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar , me shtetesi Shqipetare . Mobil: **0696424874** .

Neni 2:

Objekti

- Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm ;
- 2.1** Import-eksport, tregti te automjeteve te perdonura dhe mjeteve motorrike te ndryshme si edhe pjeseve te kembimit apo mirembajtjes se tyre.
- 2.2** Kryerje te çdo aktiviteti tjeter qe lidhet me automjetet, ne veçanti transportimin e materialeve me mjete transporti, si dhe dhenien me qera e automjeteve te cdo lloji . Marrja e perfaqesise ne aktivitetin tregtar te automjeteve.
- 2.3** Aktivitet ne fushen e ndertimit, perfshire projektim, ndertim dhe zbatim per: punime dhe germime dheu, sistemime, terracime terrenesh, murature te çdo lloji, perfshire punime dhe beton arme, parafabrikate, sistemime, ndertime civile, ekonomike, industriale, turistike, bujqesore dhe kompletim me instalimet e nevojshme per to, ndertim ujesjellesash dhe kanalizimesh, impiante per vaditje, rikonstruksion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, sisteme termike (ngrohje- ftohje) industriale, mirembajtje dhe zhvillim i dekorit ne mjedise urbane dhe çdo aktivitet te nevojshem te lidhur me ndertime e punime te inxhinierise civile. Lyerje dhe lustrim i makinave
- 2.4** Shoqeria mund të kryejë cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërise.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë per një afat te pacaktuar

Neni 4:

Selia

3.1.Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Njesia Bashkiake Nr.1, Rruga “ Agush Gjergjevica “ , Zone Kadastrale 3976, Nr.Pasurie 258/51, Shkoze , Tirane .**

3.2Adresa e komunikimit elektronik të shoqërisë është: **pashajergys@gmail.com**

Kreu II Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000** (Njëqindë mijë) Lekë **i ndarë në një kuotë**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

(1.1) Ortaku themelues **ERGYS PASHAJ** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqindëmije) Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut eshte në para. Kontributet do te derdhen mbas rregjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombëtare te Biznesit.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë pér çeshtjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm pér një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar pér mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, pér të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 pér qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare te Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Administrator i shoqerise emerohet z. **ERGYS PASHAJ e datelindjes 20.01.1988** Lindur ne **Fier** dhe banues ne **Tirane**, identifikuar nepermjet Leternjoftim me ID Nr.Personal **I80120103L**, Mobil: **0696424874**.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare te Biznesit;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar të thërasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale osesolidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkura. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV Viti finanziar-ekspertet

Neni 16

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me

kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V
Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërise.


Neni 21

Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K ËT
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ PERFECT TRADE “ SH.P.K

Ortakë themelues **ERGYS PASHAJ**



***AKT THEMELIMI
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PERFECT TRADE “ SH.P.K***

1. Emërtimi

1.1. Emërtimi i shoqërise eshte “ **PERFECT TRADE “ SH.P.K** më poshtë i quajtur “Shoqëria”

2. Personaliteti juridik

2.1. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Njesia Bashkiake Nr.1, Rruga “ Agush Gjergjevica “ , Zone Kadastrale 3976, Nr.Pasurie 258/51, Shkoze , Tirane .**

Shoqëria mund te hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera,brenda ose jashtë Republikës se Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra ne vende të ndryshme, perveç selisë së Shoqërise, brenda territorit shqiptar.

3.1. Adresa e komunikimit elektronik të shoqërisë është: pashajergys@gmail.com

4. Kohëzgjatja

4.1. Kohëzgjatja e Shoqërise është per një periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. Objekti : Objekti i shoqërise do të konsistoje:

5.1 Import-eksport, tregti te automjeteve te perdorura dhe mjeteve motorrike te ndryshme si edhe pjeseve te kembimit apo mirembajtjes se tyre.

5.2 Kryerje te çdo aktiviteti tjeter qe lidhet me automjetet, ne veçanti transportimin e materialeve me mjetet transporti, si dhe dhenien me qera e automjeteve te cdo lloji . Marrja e perfaqesise ne aktivitetin tregtar te automjeteve.

5.3 Aktivitet ne fushen e ndertimit, perfshire projektim, ndertim dhe zbatim per: punime dhe germime dhei, sistemime, terracime terrenesh, murature te çdo lloji, perfshire punime dhe beton arme, parafabrikate, sistemime, ndertime civile, ekonomike, industriale, turistike, bujqesore dhe kompletim me instalimet e nevojshme per to, ndertim ujesjellesash dhe kanalizimesh, impiante per vaditje, rikonstrukcion godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, sisteme termike (ngrohje- ftohje) industriale, mirembajtje dhe zhvillim i dekorit ne mjedise urbane dhe çdo aktivitet te nevojshem te lidhur me ndertime e punime te inxhinierise civile. Lyerje dhe lustrim i makinave

5.4 Shoqeria mund të kryejë cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

6. Kapitali i Shoqërise

- 6.1.**Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000 (Njëqindë mijë) Lekë i ndarë ne 2 (dy) kuota.
- 6.2.**Kapitali i Shoqërise përbehet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërise si me poshtë vijon:
- 6.2.1** Ortaku themelues **ERGYS PASHAJ** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 (njëqindëmije) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut eshte në para.Kontributet do te derdhen mbas rregjistrimit te shoqërise në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.3.**Kuotat jane të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe këtë Statut
- 6.4..**Pergjegjesia e ortakut për humbjet e Shoqërise shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar .

7. Asambleja e Pergjithshme

- 7.1.**Asambleja e Pergjithshme eshte organi më i larte vendimmarrës i Shoqerise dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në perputhje me ligjin dhe me Statutin dhe janë të detyrueshme per të gjithë ortakët perfshirë ata që mungojnë.
- 7.2.**Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga Statuti, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shoqërите tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme përmbrojtjen e interesave te Shoqërise.
- 7.3.**Asambleja e Pergjithshme mblidhet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjeter të shënuar në njoftimin përmblidhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithe ortakeve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbate vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.
- 7.4.**Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne jo me pak se 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.
- 7.5.**Asambleja mblidhet, cdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit finanziar, përmiratimin e raportit të administratoreve, pasqyrave financiare dhe Ilogarive vjetore.
- 7.6.**Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përmblidhje.
- 7.7.**Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet përmblidhje përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 7.8.**Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.
- 7.9.** Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblese nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë me autorizim.
- 7.10.**Autorizimi mund të jepet vetem per një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- 8. Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme :** Asambleja e Pergjithshme vends os per
- 8.1. Percaktirnin e politikave tregtare.
 - 8.2. Ndryshimet e Statutit.
 - 8.3. Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shperblimit te tij/tyre.
 - 8.4. Emerimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe eksperteve kontabël te autorizuar dhe shpërblimin e tyre.
 - 8.5. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurise se veprimitarise.
 - 8.6. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimitarise.
 - 8.7. Miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit të kapitalit te Shoqerisë.
 - 8.8. Përfaqesimin e Shoqerise në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratoreve.
 - 8.9. Shperndarjen e fitimeve
 - 8.10. Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë.
 - 8.11. Çështje tjeter të caktuar nga ligji ose nga Statuti.
 - 8.12. Çdo amendament i Aktit të Themelimit dhe Statutit.
 - 8.13. Çfarëdo transaksiioni të jashtëzakonshëm të Shoqerise, duke perfshirë bashkimet, ndarjet, transferimet, likuidimet, etj.
 - 8.14. Të gjitha aktet që përfshijnë një angazhim financiar të Shoqërise.
 - 8.15. Të gjitha instrumentet e transferimit te mallrave dhe / ose instrumenteve të Shoqerise.
9. Shoqeria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkesisë së ortakeve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.
10. Administratori/ët emërohet/n per një periudhe 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratori/ët shkarkohet/n nga detyra, në cdo kohë, me vendim te zakonshëm të Asamblese së Pergjithshme sipas ligjit. Administrator i Shoqërisë caktohet z. **ERGYS PASHAJ e datelindjes 20.01.1988** Lindur ne Fier dhe banues ne **Tirane**, identifikuar nepermjet Leternjoftim me ID Nr. Personal **I80120103L**, madhor dhe me zotesi te pote per te vepruar, me shtetesi Shqipetare. Mobil: **0696424874**. madhor dhe me zotesi te pote per te vepruar, me shtetesi Shqipetare .
11. Llogaria bankare të çelet nga Ortaket e Shoqërisë.

Nënshkruar sot më datë **08.02.2021**.

O R T A K Ë T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ PERFECT TRADE “ SH.P.K

Ortak themelues **ERGYS PASHAJ**

